



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës**  
**KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE**

Nr. 798 Prot.

Durrës më, 01 / 04 / 2026

**VENDIM**

Nr 08, datë 01/04/2026

**PËR**

**“MIRATIMIN E ZËVENDËSIMIT TË ANËTARIT STUDENT, PËR MANDAT  
PLOTËSUES, TË KOMISIONIT TË ZGJEDHJEVE TË FAKULTETIT TË BIZNESIT,  
TË UNIVERSITETIT “ALEKSANDËR MOISIU” Durrës”**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, të Ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, Durrës”, të nenit 7 të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve të para për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës”, miratuar me vendim Senati Akademik nr.29, date 29.03.2024, në kërkesën e Kryetarit të KZF-së së Fakultetit të Biznesit nr. 740 prot., datë 19.03.2026, në Vendimin KIZ nr.6, dt.25.03.202 “Hapjen e Procesit të Aplikimeve për mandat plotësues për anëtar student të KZF-së së Fakultetit të Biznesit, të Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës”, Komisioni Institucional i Zgjedhjeve,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e zëvendësimit të anëtarit student, për mandat plotësues, të KZF-së së Fakultetit të Biznesit, për arsye të mbarimit të studimeve, me studenten Martina Gjergji, bazuar në kërkesën e Kryetarit të KZF-së së Fakultetit të Biznesit.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

Ada GASHI

